




Marrëveshje Bashkëpunimi dhe Bashkëfinancimi

në mes të

Shoqatës Bëmirëse “Jetimat e Ballkanit”

dhe

Komunës së Gjakovës

Neni 1

Objekt i Marrëveshjes

Kjo marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi lidhet në mes të Shoqatës Bëmirëse Jetimat e Ballkanit, të përfaqësuar nga **Berat Kabashi, Drejtor i përgjithshëm**, dhe në mes të Komunës së Gjakovës, të përfaqësuar nga **Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës**, me qëllim të financimit të projektit të ndërtimit të 10 shtëpive.

Neni 2

Kushtet për formimin e kësaj marrëveshje

Kjo marrëveshje parasheh ndërtimin e 10 shtëpive , sipas formës me çelësa në dorë, për familjet me kushte të rënda ekonomike dhe të cilët nuk kanë kushte minimale banimi. Komuna me qëllim të krijimit të kushtëve sa më të mira për familjet sociale, pranon dhe e përkrah lidhjen e kësaj marrëveshje.

Neni 3

Qëllimi i marrëveshjes

- 3.1 Komuna me qëllim të krijimit të kushtëve sa më të mira për familjet sociale, pranon dhe e përkrah lidhjen e kësaj marrëveshje.
- 3.2 ShB “Jetimat e Ballkanit” në mënyrë vullnetare, të pavarur dhe vullnetë plotë, obligohet dhe zotohet për sigurimin e materialit për ndërtimin e shtëpive skamnore në formën qelsa në dorë.

Neni 4

Obligimet e Shoqatës

- 4.1 **Shoqata Jetimat e Ballkanit** është institucioni implementues i këtij projekti i cili parasheh periudhën e ndërtimit të shtëpive sipas programit çelës në dorë.
- 4.2 Shoqata Bamirëse “Jetimat e Ballkanit” janë të obliguar të raportojnë për përfundimin e ndërtimit të këtyre shtëpive.

Raportimi duhet të bëhet me shkrim para institucioneve të Komunës së Gjakovës

Neni 5

Afati i Realizimit

Afati i realizimit të qëllimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit duhet të arrihet brenda vitit 2021

Neni 6

Obligimet e Palëve

- 6.1 Vlera e gjithmbarshme e projektit të ndërtimit të 10 Shtëpive është **205,000.00 Euro**.
- 6.2 Komuna e Gjakovës, do të participoj shumë prej **50,000.00 Euro**.
- 6.3 Participimi nga Komuna e Gjakovës do të transferohet në llogaritë e shoqatës”, Shoqata Bemirese Jetimat e Ballkanit SHBB, me numër XK051110318280000140 ne ProCreditBank.
- 6.4 Shoqata Bamirëse Jetimat e Ballkanit do të participojnë vlerën tjetër deri në përfundimin e ndërtimit të shtëpive sipas formës çelës në dorë.

Neni 7

Formimi i Komisionit

Komisioni për përzgjedhjen e familjeve sociale, do të jetë i përbërë nga 3 anëtarë: 2 anëtarë nga shoqata Jetimat e Ballkanit dhe 1 anëtarë nga Komuna e Gjakovës.

Neni 8
Interpretimi dhe Ndryshimi

8.1 Interpretimi i kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit do të bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi, duke e ruajtur parimin e reciprocitetit.

8.2 Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit mund të bëhen vetëm me shkrim dhe të nënshkruara nga ana e dy palëve.

Neni 9
Zgjidhja e Marrëveshjes

Palët zotohen se do t'i përmbahen kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit dhe se në rast kontesti eventual apo paqartësie në tekstin e kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit, të zgjidhen me anë të bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe me mirëkuptim.

Neni 10
Shkëputja e Marrëveshjes

E drejta e shkëputjes së njëanshme të kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit, do të bëhet në rastet e shkeljeve të obligimeve që janë të përcaktuar me këtë Marrëveshje të Bashkëpunimit, duke e njoftuar palën tjetër 30 ditë para shkëputjes së Marrëveshjes.

Neni 11
Hyrja në Fuqi


Kjo Marrëveshje e Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e palëve nënshkruese.

PALËT NË MARRËVESHJE


Sh.B. Jetimat e Ballkanit

Berat Kabashi
Drejtor Gjeneral

Komuna e Gjakovës



Ardian Gjini
Kryetar i Komunës

Gjakovë, 26.04.2021